

KËRKESË PËR PROPOZIME

Integrimi i Sistemeve Digjitale të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës dhe Përmirësimi i Web Portalit

Vendi	Kosovë
Lloji i kontratës	Kontratë për shërbime
Shërbimi i kërkuar	Integrimi i Sistemeve Digjitale të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës dhe Përmirësimi i Web Portalit
Mënyra e Prokurimit	Kërkesë për Propozime Proces me një hap - do të shqyrtohen vetëm propozimet e plota
Aplikantët që mund të aplikojnë	Të gjithë entitetet e regjistruara si biznes
Data e publikimit	19 Shkurt 2024
Afati i fundit për dorëzimin e propozimit të plotë	26 Shkurt 2024
Data paraprake e fillimit të shërbimit	15 Mars 2024
Kohëzgjatja e kontratës	Sipas afatit kohor në këtë kërkesë
Raportimi	Kontraktuesi raporton te Menaxheri i projektit / Koordinatori i projektit për Kosovën
Përmbajtja e Propozimit	Propozimi duhet të përfshijë dokumentet e mëposhtme: <ol style="list-style-type: none"> 1. Certifikata e numrit unik të identifikimit të kompanisë (Kopje) dhe ekstrakt nga ARBK – Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës 2. Propozimi teknik 3. Propozimi financiar <p>Propozimet duhet të dorëzohen në format elektronik, të firmosura dhe vulosura.</p>
Ku dorëzohen propozimet	Jo më vonë se 26 Shkurt 2024 në adresat e mëposhtme al.info@swisscontact.org and ermelinda.hoxha@swisscontact.org

1. HYRJE

Tregjet aktuale të punës në Shqipëri dhe Kosovë kanë hasur në disa ndryshime pozitive gjatë viteve të fundit, duke përmirësuar shërbimet si për punëkërkesit ashtu edhe për punëdhënësit. Palët e interesuara shtetërore dhe jo shtetërore janë më të angazhuar në koordinim dhe shkëmbim për të krijuar një ekosistem më të mirë të tregut të punës. Fatkeqësisht, efektet e këtyre përpjekjeve nuk kanë arritur (ende) në segmentin e punësueshmërisë strukturore të ulët. Numri i të papunëve në Kosovë konsiderohet të jetë dukshëm më i lartë se ata të regjistruar në shërbimet publike të punësimit. Shumë prej tyre gjejnë rrugën e tyre drejt vendeve të punës dhe gjenerimit të të ardhurave që kontribuojnë në informalitet dhe shfrytëzim. Pavarësisht përpjekjeve për të futur një treg pune standard të BE-së në 25 vitet e fundit, Kosova ende përballet me sfida dhe kufizime në ofrimin e aksesit dhe adresimin e nevojave të punëkërkesve, mbështetjen e zhvillimit të aftësive të tyre dhe përshtatjen e tyre me shërbimet dhe vendet e punës nga aktorë të ndryshëm. Fatkeqësisht, ekziston një grup i madh i të rinjve, grave, pakicave etnike, njerëzve në kushte jo të mira socio-ekonomike dhe personave me përvojë të ulët arsimore dhe profesionale, të cilët përballen me punësueshmëri strukturore të ulët dhe kanë vështirësi në gjetjen e (vetë) punësimit të denjë.

Projekti Boost Employment po zbatohet nga Swisscontact në Shqipëri dhe Kosovë që nga Janari 2021. Ky projekt financohet nga qyteti i Zyrhut, Fondacioni Medicor, ndër donatorët e tjerë. Si pjesë e Programit të Zhvillimit të Swisscontact, është bashkëfinancuar nga SDC (Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, Departamenti Federal i Punëve të Jashtme FDFA). Një nga objektivat e projektit është përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike të punësimit në Shqipëri dhe Kosovë për punëkërkesit e papunë, të cilët kanë një nivel të ulët punësueshmërie apo rrezik të lartë për t'u bërë të papunë afatgjatë, duke siguruar qëndrueshmëri dhe siguri të cilësisë së këtyre shërbimeve. Një objektiv tjetër i rëndësishëm i projektit është dhe zhvillimi i mjeteve dhe instrumenteve në drejtim të digjitalizimit të ofrimit të shërbimeve të punësimit nga ofrues publikë dhe jo-publikë (organizata të shoqërisë civile), nëpërmjet moduleve të zhvilluara gjatë kohëzgjatjes së projektit në platformën <https://mundesiplot.com>.

Në Kosovë, Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës është ofrues publik i shërbimeve në tregun e punës, që ka për qëllim administrimin e tregut të punës dhe zbatimin e politikave të punësimit dhe aftësimit profesional. Shfrytëzuesit e shërbimeve të punësimit janë punëkërkesit, të papunët, punëdhënësit dhe shtetasit e huaj të cilët kanë për qëllim punësimin në Kosovë. Brenda institucionit të Agjencisë së Punësimit ekzistojnë katër sisteme të ndryshme që përbëjnë Sistemet e Informacionit dhe janë të integruara me njëri-tjetrin duke përdorur shërbimet e internetit. Këto sisteme janë:

- **Sistemi Informativ i Menaxhimit të Punësimit** është sistemi kryesor që përdoret nga Agjencia e Punësimit për regjistrimin e punëkërkesve dhe punëdhënësve dhe ofrimin e shërbimeve të punësimit dhe aftësimit profesional. Ky sistem mundëson regjistrimin e punëkërkesve dhe vendeve të lira të punës sipas kriterëve të ndryshme të dizajnuara përbrenda sistemit. SIMP është në funksion të të gjitha Zyrave të Punësimit dhe Aftësimit Profesional. I gjithë stafi i Agjencisë së Punësimit kanë rol brenda këtij sistemi.

- **Portali i Punës se Kosovës** shërben për regjistrim nga interneti për të gjithë punëkërkesit dhe punëdhënësit pa pasur nevojë të paraqiten në zyrat e punësimit. Ofrimi i shërbimeve në web platformën online, punëkërkesit mund të marrin të gjitha shërbimet e ofruara si ne regjistrimin dhe krijimin e profilit të tyre, rishikimin e vendeve të lira të punës, marrjen e informacionit për konkurset e shpallura, aplikimi i drejtpërdrejtë për vende të lira pune, rishikimi dhe aplikimi për trajnime të ofruara nga QAP-të etj. Te njëjta akses u jepet edhe punëdhënësve ku ata mund të krijojnë profilin e tyre në web platformë, të regjistrojnë vendet e lira të punës dhe të shikojnë profilet e punëkërkesve që aplikuan në vendin e lirë të punës.
- **Sistemi Informativ i Tregut të Punës (SITP)** ofron te dhëna makro duke filluar nga te dhënat e përgjithshme të popullsisë, te dhënat e popullatës me moshe pune, te fuqisë punëtore, te punësuarve, te papunëve, pensionistëve etj. Te gjitha këto te dhëna pasqyrohen në detaje sipas variablave të dizajnuara.
- **Klasifikimi i Profesioneve** në Kosovë pasqyron nomenklaturën e profesioneve në Kosovë sipas standardeve ndërkombëtare të profesioneve (ISCO 08) të dizajnuara me përshkrimin e punës, me detyrat e kryesore dhe ndërlidhjen me profesionet tjera.

Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës ka si synim që të transformojë dhënien e shërbimeve për klientët/përdoruesit e saj duke automatizuar dhe proceset e punës në mënyrë që Punëdhënësit e Punëkërkesit të vetë-shërbehën përmes përdorimit të shërbimeve digjitale.

Qëllimi i këtyre termave është që të orientojë integrimin e sistemeve (SIMP dhe Portali i Punës së Kosovës) në një platformë unike me funksione të ndara. Në këtë mënyrë Agjencia e Punësimit mund të zgjerojë ofrimin e shërbimeve ndaj punëkërkesve dhe punëdhënësve, si dhe të përmirësojë shërbimet e ofruara në Portalin e Punës për përdoruesit e saj, duke zhvilluar në të module të reja: Modulin e Vetë-vlerësimit, Modulin e-Learning dhe Modulin Video-Career. Këto module do të mundësojnë rritjen e numrit të shërbimeve të punësimit të ofruara për punëkërkesit, duke lehtësuar aksesin ndaj këtyre shërbimeve të punëkërkesve që mund t'i marrin këto shërbime pa pasur nevojë t'u drejtohen Zyrave të Punësimit. I gjithë procesi i integritit dhe zhvillimit të moduleve të reja duhet të dizajnohet në harmoni me këtë dokument, duke garantuar funksionalitetin e plotë të SIMP dhe Portalit të Punës së Kosovës dhe të dyja të jenë në dobi të ofrimit të shërbimeve të punësimit dhe aftësisë profesionale.

Projekti Boost Employment po kërkon një kompani (operator ekonomik) që të kryejë këto zhvillime teknike, sipas kushteve dhe specifikimeve të përcaktuara më poshtë. Integrimet dhe modulet duhet të jenë në harmoni të plotë me dokumentet e tjera strategjike dhe ligjore që janë në shërbim të Shërbimeve Publike të Punësimit.

2. INTEGRIMI TEKNIK MES SIMP DHE WEB PORTALIT

Shërbimet Publike të Punësimit (SHPP) aktualisht kanë në funksion SIMP dhe Portalin e Punës së Kosovës si dy sisteme që i shërbejnë punëkërkesve, të papunëve dhe punëdhënësve që po përdorin gjithnjë e më shumë kanale dixhitale si pjesë e një qasjeje të kombinuar të ofrimit të shërbimeve. Ofrimi i shërbimeve të SHPP-së përmes kanaleve dixhitale rrit aksesin e shërbimit, pasi ai nuk ndikohet nga kufizimet e shërbimeve ballë për ballë, siç janë orët e punës së zyrave dhe rrit kapacitetin e SHPP-

së për të ofruar shërbime edhe më cilësore apo për një numër më të madh klientësh.

Gjithashtu, mjetet digjitale të përdorura mund të ofrojnë një sistem më transparent të përputhjes së vendeve të lira dhe punëkërkesve dhe të lehtësojnë përdorimin e të dhënave për qëllime të ndryshme të Agjencisë.

Për këtë arsye Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës ka si objektiv integrimin teknik mes sistemit SIMP dhe portalit të punës. Duke mundësuar integrimin teknik, do të mundësohet komunikimi i të dhënave që secila prej tyre mban, do të shmangen dublikimet e të dhënave të punëkërkesve të regjistruar, duke dhënë një efekt të rëndësishëm në gjenerimin dhe aksesin në sasi të mëdha të të dhënave dhe informacioneve.

Shërbimet elektronike të ofruara do të përfshijnë:

- regjistrimin online,
- përputhjen e automatizuar të vendeve të punës,
- 'bisedat' udhëzuese dhe
- webinarë.

Shërbimet Publike të Punësimit ofrojnë shërbime për këto kategori, si:

- ☑ **Punëkërkesit e regjistruar:** Grupi i parë përbëhet nga çdo person që kërkon punë prej moshës pesëmbëdhjetë (15) deri tetëmbëdhjetë (18) vjeçare, personat që punojnë me orar të plotë apo gjysmë orari dhe personat që janë pezulluar përkohësisht nga puna, të cilët janë të regjistruar në sistemin e shërbimeve *online* të APRK;
- ☑ **Të papunët e regjistruar:** Grupi i dytë përbëhet nga çdo person i moshës mbi tetëmbëdhjetë (18) deri gjashtëdhjetekatër (64) vjeçare, i papunë dhe i regjistruar në APRK (Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës) përmes Zyrave të Punësimit;
- ☑ **Punëdhënësi i regjistruar:** Personi fizik ose juridik i cili i siguron punë punëmarrësit dhe i paguan pagën për punën ose për shërbimet e kryera, dhe i cili regjistrohet në Zyrën e Punësimit personalisht ose në sistemin e shërbimeve *online* të APRK.

Shërbimet e ofruara për punëkërkesit/të papunët e regjistruar në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Punësimit (SIMP) janë aktualisht të ndarë në hapa si vijon:


1. Regjistrimi;
2. Profilizimi;
3. Këshillimi;
 - 3.1. Këshillimi për punësim;
 - 3.2. Këshillimi për karrierë;
 - 3.3. Këshillimi për orientim në aftësimin profesional;
4. Ndërmjetësimi në punësim të rregullt;
5. Ndërmjetësim në masa aktive të tregut të punës.

Shërbimet e ofruara për Punëdhënësit e regjistruar në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Punësimit (SIMP) janë aktualisht të ndarë në hapa si vijon:

1. Regjistrimi;
2. Shpallja e vendeve të lira të punës;
3. Ndërmjetësimi ose shërbimet e para-zgjedhjes së rekrutimit;
4. Shërbimet e zgjedhjes së kandidatit për rekrutim;
5. Shërbime për Punësimin e Rregullt dhe Masa Aktive të Tregut të Punës.

Të gjithë hapat e mësipërm, aktualisht funksionalë dhe të përmirësuar së fundmi si pjesë e SIMP, duhet të jenë pjesë e sistemit të ri-integruar bashkë me web portalin, duke mundësuar kështu një komunikim në kohë reale ndërmjet tyre.

Grafika e integrimit të Web-it me SIMP



Përmes integrimit teknik synohet të arrihet:

- 1- Të ruhen të gjitha shërbimet e punësimit që aktualisht ofrohen përmes SIMP. Të përshtaten të gjithë hapat brenda një sistemi si shërbim shumë kanalesh.
- 2- Përdoruesve (zyrtarëve të Agjencisë së Punësimit, punëkërkesve dhe punëdhënësve) duhet tu ofrohet vetëm 1 ndërfaqe, ku ata të mund të krijojnë llogari apo të aksesojnë llogarinë e tyre për të marrë apo përdorur shërbimet e punësimit. Si bazë për ndërfaqen e re mund të mbahet njëra prej dy sistemeve apo të krijohet diçka më inovative.
- 3- Integrimi i databazave në 1 databazë të vetme. Rrjedhimisht edhe punëkërkesit e regjistruar në web portal të unifikohen dhe të marrin sa më shumë shërbime të jetë e mundur krahasuar me përdoruesit që regjistrohen përmes SIMP. Praktikisht të dizajnohen shërbimet të cilat do të ofrohen online si shërbime të shtuara dhe të integrohen shërbimet që do të merren në Zyrat e Punësimit përmes SIMP.
- 4- Të krijohet brenda platformës identifikimi i punëkërkesit sesi është regjistruar (regjistrim online apo me prezencë fizike në Zyrat e Punësimit). Përdoruesit zyrtarë të Agjencisë së Punësimit të

kenë mundësi të identifikojnë automatikisht punëkërkesit nëse janë regjistruar përmes SIMP apo përmes web portalit, në mënyrë që të mundësojnë hapa të tjerë në ofrimin e shërbimeve të punësimit.


- 5- Profilizimi / Kategorizimi i punëkërkesve të vijë si informacion nga SIMP dhe ky informacion do të shfaqet secilit punëkërkes në llogarinë e tij. Profilizimi i punëkërkesve do të mundësojë kategorizimin e tyre, në mënyrë që punëkërkesit me rrezikshmëri të ulët të mund të marrin shërbimet online direkt përmes platformës dhe punëkërkesve me rrezikshmëri të lartë për tu bërë të papunë tu shfaqet informacioni që duhet të drejtohen në Zyrat e Punës. Ofrimi i shërbimeve duhet të dizajnohen në hapa sipas mënyrës së ofrimit të shërbimeve nga Shërbimi Publik i Punësimit.
- 6- Integrimi të mundësojë edhe një auto-matching midis të dhënave të profilit që punëkërkesi ka vendosur me kriteret e përcaktuara në secilën vend të lirë të punës të postuar nga ana e punëdhënësve. Kriteret që do të përdoren për auto-matching janë:
 - a) Kualifikimi/niveli i arsimimit
 - b) Profesioni/titulli (sipas ISCO-08);
 - c) Adresa e vendit të punës;
 - d) Eksperienca në punë;
 - e) Sektori (sipas NACE);
 - f) Etj.
- 7- Secili punëdhënës i regjistruar pasi të shpallë një vend të lirë të punës, të ketë akses tek të dhënat e punëkërkesve që i plotësojnë kriteret për atë Vend të Lirë të Punës. Përmes auto-matching, vetë sistemi duhet të jetë i aftë të gjenerojë një listë për punëdhënësin me të dhënat e punëkërkesve që plotësojnë kriteret e përcaktuara në secilën prej Vendeve të Lira të Punës të postuara. Punëkërkesit në sistem duhet të bien dakord që të dhënat e tyre personale të ndahen me punëdhënës potencialë ku ata aplikojnë.
- 8- Po ashtu secili punëkërkes i regjistruar të ketë akses tek Vendet e Lira të Punës. Sistemi duhet të mundësojë punëkërkesve një listë me Vendet e Lira të Punës, sipas kriterëve përkatëse të përputhshmërisë.

Shënim: Tek SIMP dhe Web portalit i Punës së Agjencisë së Punësimit duhet të ruhen dhe migrohen me sukses informacionet e profileve dhe historiku ekzistues i të gjithë punëkërkesve të regjistruar aktualisht, ndërsa avancohet me format e ndryshme që ndodhen në këto sisteme.

3. ZHVILLIMI I MODULEVE TË REJA NË WEB PORTAL

Modulet e reja që do të zhvillohen në web-portal duhet të ndërliken në sistemin e ri-integruar sipas skemës së mëposhtme:

Figura 2: Integrimi i SIMP me Web Portalin dhe Zhvillimi i moduleve të reja



Aktualisht disa prej moduleve në Web Portalin e Agjencisë janë funksionale dhe disa të tjera janë duke u përmirësuar. Përmes kësaj kontrate synohet zhvillimi nga e para e këtyre moduleve:

- 1- Moduli i Vetë-Vlerësimit
- 2- Moduli e-learning
- 3- Moduli Video Career
- 4- Kanalet e komunikimit

3.1. Moduli i vetë-vlerësimit


Moduli i vetë-vlerësimit duhet të zhvillohet në portalin web të Agjencisë së Punësimit. Ky modul të jetë i hapur për të gjithë përdoruesit që aksesojnë portalin e Agjencisë, pa pasur nevojë që ata të kenë një llogari në të. Në këtë modul do mundësohet kryerja e një testi, përmes të cilit punëkërkuessit do të arrijnë të kuptojnë cilat profesione ju interesojnë atyre më shumë. Rezultatet e testit do t'i pajisin ata me më shumë informacion mbi kompetencat që kërkohen të zotërohen për secilën nga profesionet që punëkërkuessit kanë interes. Pasi punëkërkuessit kryejnë testin e vetë-vlerësimit të interesave profesionale, do të kenë mundësinë të shohin vendet e lira ekzistuese të punës që mund të jenë të disponueshme sipas interesave personale që ata kanë identifikuar në bazë të rezultateve të testit.

Ky modul duhet të dizajnohet si një seri pyetjesh dhe përgjigjesh ose teste me shumë zgjedhje, gjithmonë të shoqëruara me një imazh të vogël, grafik, ilustrim dhe duhet të shfaqen një ose dy pyetje në një kohë, kështu që përdoruesi nuk mbingarkohet.

Modele të gatshme testesh mund të përdoren si shembuj për zhvillimin e këtyre testeve. Gjithashtu databaza të instrumentave të tillë të zhvilluar nga vetë Agjencia e Punësimit apo dhe projekti Boost Employment mund të vihen në dispozicion të kompanisë zhvilluese për dizajnimin dhe zhvillimin e modulit të vetë-vlerësimit.

3.2. Moduli e-learning

Moduli I e-learning duhet të ketë kurse e-learning për aftësitë e buta. Ky modul do të jetë i hapur për të gjithë përdoruesit e Shërbimeve Publike të Punësimit të cilët mund ta aksesojnë këtë modul pa u loguar në llogarinë e tyre në sistemin e ri-integruar. Ky modul do të shërbejë punëkërkuësve që të zhvillojnë kompetencat e tyre kryesisht kompetencat personale, sociale dhe metodologjike për t'ju përshtatur sa më shumë kompetencave që kërkohen në profesionet e tyre të interesit. Ne propozojmë të integrohet Moodle (ju mund të propozoni platforma LMS të tjera), si një mjet me burim të hapur dhe miqësor për përdoruesit për të krijuar kurse e-learning për punëkërkuësit. Moodle duhet të integrohet brenda portalit të Agjencisë dhe përmes single sign-on, punëkërkuësit duhet të kenë mundësinë të aksesojnë modulet e e-learning direkt në Moodle. Gjithashtu, nëpërmjet single sign-on edhe krijuesit e kurseve e-learning (përdoruesit që Agjencia zgjedh për këtë qëllim) duhet të krijojnë përmbajtje për kurset e e-learning dhe t'i bëjnë ato të disponueshme për punëkërkuësit. Në figurën e mëposhtme është paraqitur mënyra e paraqitjes së kurseve e-learning të krijuara me Moodle, në platformën “mundësiplot”:



3.3. Moduli Video Career

Moduli i Video Career duhet të funksionojë si një modul i mirë për orientimin në karrierë. Ky modul do të jetë i hapur për të gjithë përdoruesit e Shërbimeve Publike të Punësimit. Ky modul duhet të ketë një kontent të qartë për :

- Video karrierë (video të ndryshme për kurse profesionale, për këshillime në punësim etj)
- Video animacione dhe informacione të tjera të ndryshme që lidhen me planifikimet dhe zhvillimin e karrierës
- Intervista pune
- Etj.

Moduli duhet të ndërlidhet me rrjete sociale si Facebook, Instagram, Youtube etj, dhe çdo video e re të transmetohet në këto kanale.

3.4. Kanalet e Komunikimit

3.4.1. Chat Communication

Të zhvillohet mundësia e komunikimit me tekst, me pyetje dhe përgjigje më të shpeshta (Frequently Asked Questions – FAQ) të para-konfiguruar orientuese për përdoruesit e Shërbimeve Publike të Punësimit.

4. SPECIFIKIMET TEKNIKE DHE FUNKSIONALE TË SOFTUERIT

4.1 Arkitektura e softuerit

- Softueri i bazës së të dhënave duhet të jetë i dizajnuar asisoj që të mundësojë ruajtjen e shënimeve direkt në databazën qendrore.
- Softueri duhet të ketë qasje për numër të pa kufizuar të shfrytëzuesve të cilët do menaxhohen nga administratori me role dhe privilegje.
- Sistemi duhet të ketë modulën e administratorit.
- Çdo fushë e përcaktuar si drop-down list dhe mundësi të navigimit të avancuara duhet të jetë e konfigurueshme nga administratori.
- Sistemi duhet të integrohet dhe të ndërtohet në platformë Microsoft, që të mundësohet hostimi në Windows 2016/2019 R2 Server apo më lart.
- Sistemi duhet të jetë i bazuar në arkitekturën e bazuar në teknologjinë klient/server.
- Kanali transmetues për të dhënat sensitive duhet të jetë i siguar.
- Ndërfaqet (interface për shfrytëzuesit e brendshëm) duhet të jenë të lehta për përdoruesin “user- friendly” dhe të qëndrueshme.
- Ndërfaqet duhet të përmbajnë kontrollet më të reja të bazuara në Ajax.
- Aplikacioni softuerik duhet të jetë i përputhshëm me rekomandimet për Web 2.0
- Aplikacioni softuerik duhet të jetë i përshtatshëm me shfletuesit më të njohur në treg si Microsoft Edge, Mozilla Firefox, Google Chrome, Safari, etj.

4.2 Teknologjia e zhvillimit

- Aplikacioni softuerik duhet të zhvillohet në Microsoft ASP.NET/C#.
- Aplikacioni softuerik duhet të hostohet në server i bazuar në Microsoft Internet Information Services (IIS).
- Baza e të dhënave duhet të ndërtohet në platformën MS SQL (SQL Server 2016+).
- Ndërfaqet e shfrytëzuesve (Interface) duhet të jenë të zhvilluara në platformat e Microsoft.

4.3 Siguria e Softuerit/Aplikacionit

- Softueri duhet të ketë siguri të nivelit të lartë dhe të pranueshëm në mënyrë që të mbrojë integritetin e të dhënave.
- Sistemi duhet të mundësojë një ambient të sigurt, të ndarë dhe të integruar për të gjitha njësitë funksionale të bazës së të dhënave.
- Çdo metodë e qasjes së bazës së shënimeve qendrore përmes aplikacionit të sistemit apo ndonjë programi të jashtëm duhet të bëhet përmes një identifikuesi dhe një fjalëkalimi duke zbatuar praktika më të mira. (Të mundësohet/përkrahet gjithashtu aksesimi me dy hapa siguri).
- Ruajtja e fjalëkalimit duhet të bëhet në atë mënyrë që mos të ekzistojë mundësia e detektimit, por vetëm e resetimit.
- Sistemi varësisht nga niveli – kategoria e shfrytëzuesve duhet të mundësojë vetëm lexim të të dhënave, editim të kufizuar si dhe qasje të plotë në bazën e të dhënave apo dhe mundësinë e konfigurimit për ofrim e qasjes për të gjitha objektet në bazën e të dhënave varësisht nga kërkesat.
- Sistemi duhet të mundësojë konfigurim të lehtë të drejtave të përdoruesve dhe duhet të mundësojë përshtatjen e të drejtave me politikat e brendshme institucionale edhe në rastet e ndryshimit të politikave.
- Aplikacioni softuerik duhet të mundësojë konfigurimin dhe administrim të qasjes për të gjithë shfrytëzuesit e brendshëm.
- Çdo shfrytëzues duhet të qaset në sistem përmes një login-i dhe fjalëkalimi.
- Qasja në sistem duhet të bëhet përmes protokollit të sigurt HTTPS.
- Sistemi duhet të jetë i siguar me SSL përmes certifikatës digjitale.
- Administratori i sistemit duhet të ketë mundësinë e caktimit të kufizimeve për shfrytëzuesit, të tilla si: skadimit të fjalëkalimit, kriteret për fjalëkalim të komplikuar, intervale kohore të caktuar të qasjes etj. (specifikat e tjera mund të përcaktohen nga administratorët).
- Aplikacioni softuerik duhet të mundësojë qasjen, insertimin, ndryshimin dhe fshirjen e të dhënave bazuar në të drejtat e profilit të shfrytëzuesit. Të drejtat e shfrytëzuesit duhet të kenë mundësinë e konfigurimit nga administratori i sistemit.
- Aplikacioni softuerik duhet të mundësojë auditim të plotë të të gjitha ngjarjeve në sistem (koha, ngjarja, shfrytëzuesi, sukses/dështim, shfrytëzues dhe makine/pc).
- Sistemi nuk duhet të lejojë që të kyçet në të njëjtën kohë dy përdorues me të njëjtin username dhe fjalëkalim.
- Aplikacioni softuerik duhet të ketë një mekanizëm të bllokimit të llogarisë (account) në rast të tri dështimeve radhazi për login pas tentimeve si p.sh. duke implementuar politikat min 5 herë.
- Administratori i sistemit për regjistrimin e punëkërkuessve të paautorizuar në bazë të të dhënave duhet të njoftohet sa më shpejt përmes e-mailit për ngjarjet në vazhdim:
 - Bllokimi i llogarisë së shfrytëzuesit
 - Tentimi i qasjes së paautorizuar.
- Aplikacioni softuerik duhet të ketë mundësinë e përdorimit të “Hot-keys” për të mundësuar punën në funksione të caktuar pa përdorimin e miut (kompjuter mouse).
- Sistemi duhet të ketë mundësinë e auditimit për të gjitha informacionet e ruajtura në bazën e të dhënave dhe ndryshimet e kryera në to.
- Sistemi duhet të ketë mundësinë e enkriptimit të të dhënave që cilësohen si sensitive.
- Sistemi duhet të ketë mundësinë e enkriptimit të të dhënave për lidhjen me bazën e të dhënave.
- Sistemi duhet të ketë një funksion kërkues, e cila duhet të mund të përdoret pa pasur nevojën

e ekzekutimit të kodeve/skriptave në SQL.

- Sistemi duhet të mundësojë kërkimin e përafërt dhe kërkimin e saktë.
- Sistemi duhet të mundësojë gjenerimin e raporteve të ndryshme në bazë të kërkesave.
- Sistemi duhet të ketë mundësinë e krijimit të një lloji data-dictionary dhe vegla përkatëse, në mënyrë që të mundësojë gjenerimin e raporteve të ndryshme pa pasur nevojë të përdoren kodet-skripta programuese (p.sh. crystal report).
- Aplikacionit softuerik duhet t'i lejohej mundësia e komunikimit në të ardhmen me sisteme të tjera përmes web shërbimeve.
- Sistemi duhet të ketë mundësinë që të ruaj një sasi të madhe të të dhënave, përpunim efikas në kohe si dhe arkivimin e tyre.
- Sistemi duhet të mundësojë shpërndarjen e raporteve përmes e-mailave në formate të ndryshëm si xls, xml, pdf, etj., varësisht nga kërkesat.

4.4 Trajnimi dhe dokumentimi

Operatori ekonomik duhet të ofrojë nga një kopje për secilin prej këtyre dokumenteve:

- Manualin e përdorimit për përdorimin dhe administrimin e sistemit;
- Manualin për instalim dhe mirëmbajtje;
- Manualin e shfrytëzuesit;
- Materialin me shembuj të trajnimit;
- Shembuj të skripteve të testimit të sistemit.
- Operatori ekonomik duhet të mundësojë një trajnim adekuat të personelit zyrtarë të Agjencisë së Punësimit sipas planeve të dorëzuara të trajnimit, në fushat e caktuara :
 - Instalim
 - Konfigurim
 - Përdorim dhe
 - Mirëmbajtje të sistemit bazuar në kërkesat e cekura në këtë dokument.
- Trajnimi mbi sistemin SIMP të ri-integruar duhet të realizohet në 7 rajone të Kosovës (përafërsisht përdorues do të jenë mbi 100 persona – zyrtarë të Agjencisë së Punësimit).

4.5 Përkrahja e shumë-gjuhësisë

- Sistemi i ri i ri-integruar duhet të jetë i punuar në të gjitha gjuhët zyrtare sipas legjislacionit në fuqi.

4.6 Kodet burimore

- Operatori Ekonomik me rastin e dorëzimit- pranimit të softuerit, duhet të bëjë edhe dorëzimin e kodeve burimore të dokumentuara në formë të shkruar dhe elektronike.
- Kodet burimore dhe komplet softueri me rastin e dorëzimit të tyre do të jenë pronë e pakontestueshme e Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës (APRK) dhe APRK e ruan të drejtën e modifikimit të sistemit përmes kodeve burimore pa pasur nevojë të konsultohet me kompaninë që ka zhvilluar sistemin.
- Pronësia e kodeve burimore nuk e përjashton të drejtën e kompanisë që të marrë pjesë në tenderët e hapur për avancim apo mirëmbajtje të këtyre sistemeve, mirëpo kompania do të trajtohet barabartë me konkuresit e tjerë. E drejta e autorit në kuptimin moral të fjalës do t'i takojë zhvilluesit (kompanisë) në mënyrë që t'i shërbejë si referencë pune.

4.7 Interoperabiliteti (ndërveprueshmëria) me burimet e tjera

Aktualisht lidhjet e mëposhtme janë ekzistuese si në SIMP ashtu edhe në web-portalin e Agjencisë. Duke qenë se përmes këtyre TORS synohet integrimi i tyre në një sistem të vetëm, duhet të sigurohet

që ky sistem komunikon përmes platformës GG, me databazat e institucioneve të mëposhtme.

Institucionet me të cilat duhet të vazhdojë të ndërveprojë sistemi i ri-integruar, përmes API (Application Programming Interface) web- aplikacioneve/data-bazave janë si më poshtë por jo të kufizuara vetëm në to.

- **Administrata Tatimore e Kosovës** – kontrollon punëkërkesit nëse janë të regjistruar në bazën e të dhënave të administratës tatimore, nëse janë të punësuar;
- **Baza e të dhënave – Kategoria II:** ky shërbim në internet kontrollon të gjithë punëkërkesit që kanë marrë certifikatën e papunësisë nëse kanë marrë asistencë sociale nga Kategoria II. Gjithashtu dërgon të dhëna në bazën e të dhënave të Kategorisë II për punëkërkesit në këtë skemë;
- **Ministria e Punëve të Brendshme** – Departamenti për Ri integrimin e të dhënave të Personave të Riatdhesuar – mbledh të dhëna për punëkërkesit e riatdhesuar të regjistruar në MPB dhe vërteton shënimet;
- **Agjencia e Regjistrimit Civil:** verifikimi i të dhënave të regjistruarve.

5. AFATI KOHOR

Përfituesi kërkon që aplikacioni softuerik të dorëzohet brenda 5 muaj pas nënshkrimit të kontratës, duke përfshirë këtu fazën e pilotimit dhe mbylljen. Kontraktori duhet të ofrojë garanci dhe mbështetje për mirëmbajtjen, që nga momenti kur versioni përfundimtar është instaluar, është funksional dhe ka përfunduar trajnimi, deri në Dhjetor 2024.

Zbatimi i projektit mund të zhvillohet në 4 faza:

Faza 1: Faza fillestare - 2 javë

Një (1) javë pas nënshkrimit të kontratës, kontraktori duhet t'i dorëzojë përfituesit raportin fillestar lidhur me: përbërjen e ekipit të projektit; planin dinamik të projektit me datat e raportimit; komentet dhe rekomandimet mbi projektimin konceptual të sistemit të parashikuar në këtë ToR, etj). Plani i projektit duhet të miratohet nga përfituesi përpara fillimit të ndonjë aktiviteti zhvillimor dhe fillimit të fazës 2 (Analiza dhe Dizajni i Sistemit).

Faza 2: Analiza dhe Dizajni i Sistemit – 2 javë

Kjo fazë përfshin veprimet e mbledhjes së informacionit për Kontraktorin për të analizuar të gjitha aspektet e sistemit të ardhshëm dhe për të kryer zhvillimin dhe dizajnimin e aplikacionit softuerik. Dizajni përfundimtar i sistemit (dizajni i bazës së të dhënave, logjika e sistemit, ndërfaqja, dizajni grafik, etj.), në formën e specifikimeve të sistemit, duhet të miratohet nga përfituesi. Vini re se kërkesat nuk janë përfundimtare të fiksuara në fazën e mëparshme, që do të thotë se klienti ka të drejtë të modifikojë dhe ndryshojë më tej kërkesat gjatë kësaj faze, por duke mos tejkaluar 30% të rasteve të përdorimit të rënë dakord.

Faza 3: Zhvillimi/programimi – 3 muaj

Pasi analiza dhe dizajni të jenë përfunduar dhe miratuar nga klienti, Kontraktori do të fillojë fazën e zhvillimit. Gjatë kësaj faze, Kontraktori lejohet të kërkojë takime shtesë me klientin për të sqaruar çështjet që do të ngrihen në procesin e zbatimit, në mënyrë që të zhvillojë aplikacionin softuerik që do t'i përshtatet më së miri qëllimit të tij. Kontraktori është përgjegjës për të siguruar të gjitha mjetet dhe mjediset e zhvillimit me koston e tij.

Faza 4: Testimi dhe zbatimi përfundimtar – 1 muaj

Kërkoheq që Kontraktori të testojë plotësisht aplikacionin softuerik për shkelje të sigurisë, çështje funksionale dhe defekte të mundshme. Kontraktori do të jetë përgjegjës për futjen e saktë të grupit fillestar të kodeve, klasifikimeve dhe të dhënave të tjera të konfigurimit. Projekti do të kalojë në fazën tjetër vetëm kur klienti të ketë miratuar fazën e testimit. Zbatimi i sistemit do konsiderohet i përfunduar vetëm pasi të instalohet dhe të jetë në funksion të plotë.

6. PROFILET E EKSPERTËVE

Operatori Ekonomik (Kompania) për të ofertuar duhet të ketë minimum prej 5 personave si staf profesional për realizimin e këtij projekti si:

Menaxher i Projektit (1)

Edukimi:	Diplomë universitare në TIK, Menaxhim ose certifikim profesional në fusha relevante
Përvoja profesionale:	Minimum 10 vjet përvojë pune në projekte që ndërlidhen me zhvillimin e sistemeve informative dhe menaxhimin e projektit (dëshmi kontratat ose referencat që duhen ofruar); Të ketë përvojë në shkrimin e raporteve (dëshmi referenca që duhet ofruar)
Aftësitë gjuhësore:	Të njohë gjuhën shqipe, angleze dhe serbokroate

Zhvillues i aplikacioneve softuerik (2)

Edukimi:	Diplomë universitare në TIK ose certifikim profesional te Microsoft etj.
Përvoja profesionale:	Minimum 7 vjet përvojë pune në projekte që ndërlidhen me zhvillimin e sistemeve informative (dëshmi kontratat ose referencat që duhen ofruar);
Aftësitë gjuhësore:	Të njohë gjuhën shqipe, angleze

UI/Web - Dizajner i aplikacionit softuerik (1)

Edukimi:	Diplomë universitare në TIK ose certifikim profesional te Microsoft etj.
Përvoja profesionale:	Minimum 3 vjet përvojë pune në projekte që ndërlidhen me dizajnimin e sistemeve informative (dëshmi kontratat ose referencat që duhen ofruar);
Aftësitë gjuhësore:	Të njohë gjuhën shqipe, angleze

Trajner (1)

Edukimi:	Diplomë universitare në TIK ose certifikim profesional te Microsoft etj.
Përvoja profesionale:	Minimum 3 vjet përvojë pune në projekte që ndërlidhen me trajnimin e shfrytëzuesve te sistemeve informative (dëshmi referencat që duhen ofruar);
Aftësitë gjuhësore:	Të njohë gjuhën shqipe, angleze dhe serbokrate

7. LISTA E REFERENCAVE

Të paraqitet lista e projekteve të kryera në fushat e ngjashme që ndërlidhen me tregun e punës, sipas tabelës:

Nr.	Emri i Projektit	Institucioni	Koha e realizimit
1			
2			
3			
4			
5			

8. FORMATI I PROPOZIMIT

Kontraktuesi duhet të plotësojë të gjithë komponentët e Kriteve të Vlerësimit dhe Përzgjedhjes. Ofruesi duhet t'i përgjigjet temave kryesore të secilit prej kriteve të vlerësimit dhe përzgjedhjes të përshkruara më sipër. Ofruesi duhet të sigurojë shembujt përkatës, shembuj të produkteve të punës ose referenca. Komisioni Përzgjedhës mund të kërkojë përgjigje të hollësishme shtesë.

Dokumentacioni që duhet të dorëzohet

A. ÇERTIFIKATA UNIKE E NUMRIT TË IDENTIFIKIMIT TË KOMPANISË (KOPJE) DHE EKSTRAKT NGA ARBK - Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve

B. PROPOZIMI TEKNIK

1. Profili i kompanisë duke përfshirë sa vijon:

- Emri i kompanisë
- Struktura e pronësisë: Përshkruani llojin e njësisë ekonomike
- Vite në funksion
- Lokacionet e zyrave të tjera që mund të ketë kompania
- Numri kryesor i telefonit
- URL e faqes së internetit të kompanisë
- Personi kryesor i kontaktit (emri, titulli, telefoni dhe adresa e emailit)
- Numri total i punonjësve

2. Përvoja dhe kualifikimet

Propozimi duhet të përfshijë dokumentacionin e mëposhtëm në lidhje me përvojën dhe kualifikimet:

- Listoni përvojat e mëparshme duke përfshirë pasqyrën e shërbimeve në fusha të ngjashme dhe të rëndësishme për dorëzimet e parashikuara në këto Terma Reference.
- Tre referenca të punëve më të mira të kompanisë, që lidhen me produktet e kërkuara në këto Terma Reference, duke përfshirë: emrin e kompanisë, emrin e klientit primar, detajet e kontaktit dhe shpjegimin e shkurtër të shërbimeve të ofruara.

3. Metodologjia dhe qasja ndaj zgjidhjes teknike të ofertuar

3.1 Plani dhe qasja e propozuar e punës:

- 3.1.1 Metodologjia që do të përdoret;
- 3.1.2 Një plan pune i qartë dhe konciz që tregon aktivitetet dhe datat e synuara për përfundimin e tyre;
- 3.1.3 Një përshkrim të rezultateve të pritura për aktivitetin;
- 3.1.4 Një përmbledhje e personelit kyç (duke përfshirë CV-të) dhe përgjegjësitë e tyre specifike të punës (siç kërkohet më lart);

C. PROPOZIMI FINANCIAR

Propozimi financiar duhet të ndahet sipas fazave të përmendura më sipër. Për fazën e zhvillimit, ofertuesi duhet të specifikojë kostot si më poshtë:

1. Jepni një plan kostosh për të gjitha shërbimet përkatëse të përshkruara si më poshtë:

1.1. Integrimi i bazës së të dhënave

- 1.2. Zhvillimi i ndërfaqes
 - 1.3. Moduli i vetëvlerësimit bazuar në shembujt që parashtrihen në këto Terma Reference dhe Aneks
 - 1.4. Moduli i e-learning
 - 1.5. Moduli i video-career
 - 1.6. Kanalet e komunikimit
2. Buxheti total i kërkuar (all inclusive), i detajuar, bazuar në të gjitha shërbimet e ofruara
 3. Ju lutemi specifikoni nëse përfshihet TVSH në buxhetin e propozuar. Një propozim financiar me një shumë të vetme (lump sum), përbën arsye për të mos u pranuar.

Projekti rezervon të drejtën të kërkojë zbatimin e pjesëshëm të termave të referencës në varësi të kostove të propozuara.

Kriteret e Vlerësimit

Një panel vlerësimi, i përbërë nga jo më pak se 3 (tre) anëtarë, do të vlerësojë aplikimet sipas kriterëve të përcaktuara në këtë dokument tenderimi. Swisscontact Albania do të vlerësojë aplikimet e marra brenda një muaji pas përfundimit të afatit të aplikimit.

Propozimet që plotësojnë kërkesat e parashtruara më sipër (pika 8.A), do të vlerësohen me kriteret e mëposhtme:

- | | |
|---|------------|
| • Propozimi teknik | 70% |
| - Profili i kompanisë | 10% |
| - Eksperienca dhe kualifikimi | 20% |
| - Metodologjia dhe qasja ndaj projektit | 40% |
| • Propozimi Financiar | 30% |

9. INSTRUKSIONET PËR DORËZIM

Afati i fundit i dorëzimit është jo më vonë se **ora 17:00, më 26 Shkurt 2024**. Ju lutemi vini re se në rast se oferta juaj do të dërgohet më vonë se afati i fundit për dorëzim, Swisscontact mund të vendosë të skualifikojë dorëzimin tuaj dhe të mos e konsiderojë atë të pranueshëm për fazat e mëtejshme të vlerësimit.

Të gjitha aplikimet do të dorëzohen vetëm me email (të nënshkruar, të vulosur dhe të skanuar) brenda afatit të lartpërmendur në adresat al.info@swisscontact.org dhe ermelinda.hoxha@swisscontact.org. Ju lutemi specifikoni në subjektin e emailit, titullin e kërkesës për propozim: **Integrimi i Sistemeve Digjitale të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës dhe Përmirësimi i Web Portalit**. Të gjitha dokumentet duhet të nënshkruhen dhe vulosen.

Aplikimi DUHET të përmbajë të gjithë dokumentacionin e kërkuar, përndryshe mund të eliminohet automatikisht nga Swisscontact pa një kërkesë të mëtejshme për sqarim dhe/ose plotësim.

